



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 38/2011
Prishtinë, më 09. 11. 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01. 11. 2011;
3. Propozim-Plani i Veprimtimit i Kuvendit për vitin 2012 i Raportit të Progresit 2011 për Kosovën – detyrimet e Komisionit;
4. Informatë rreth vizitës së Komisionit në Republikën e Shqipërisë më 24 - 26 tetor 2011;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01. 11. 2011

Procesverbali i mbledhjes datës 01. 11. 2011 u miratua pa vërejtje.

3. Propozim-Plani i Veprimit i Kuvendit për vitin 2012 i Raportit të Progresit 2011 për Kosovën – detyrimet e Komisionit

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se për këtë pikë të rendit të ditës, është nxjerrë një draft nga Njësia Mbështetëse, ku janë përcaktuar disa sfida sa i përket Planit të Veprimit të Kuvendit për vitin 2012 të Raportit të Progresit 2011 për Kosovën, respektivisht detyrimet që ka Komisioni. Në vazhdim kërkoi të diskutohet për të gjitha pyetjet që i janë parashtruar Komisionit për veprimet e propozuara.

Visar Ymeri – Propozoi që pyetjet nr. 81, 86 dhe 96 të hiqen, sepse nuk janë fushë e veprimit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Këto janë fusha dhe çështje që mbulohen nga komisionet e tjera.

Myzejene Selmani – Pyetja nr. 96 paraqet problem, sepse Kosova është renditur poshtë në ranglistën e Bankës Botërore. Pra, Banka Qendrore e Kosovës duhet të mbikëqyrë edhe nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik. Në këtë rast edhe guvernatori duhet të vijë në Komision dhe të raportojë për politikat kreditore. Kërkoi që çështja e periudhës kohore të zbatohet në mënyrë strikte. Sa i përket raportimit, kërkoi nga ministritë dhe nga agjencitë e pavarura, që i mbikëqyr Komisioni, të raportojnë me kohë në bazë të Planit të Veprimit.

Lutfi Zharku - Për pyetjen nr. 82 mund të kërkojmë nga MTI-ja raporte për politikat tregtare; për pyetjen nr. 94 të kërkohet të raportojë dhe Administrata Tatimore e Kosovës; në pyetjen nr. 95 të hiqen fjalët “standardet ndërkombëtare” nga veprimi i propozuar. Në fund z. Zharku tha se çështjet që i përkasin ministrisë së njëjtë të vendosen në një tremujor, sepse kur të ftohet ministri përkatës për të raportuar, duhet të raportojë për të gjitha sfidat.

Hashim Deshishku - Tha se te pyetja nr. 86 të kërkohej nga Banka Qendrore e Kosovës të raportojë për punën e kompanive të sigurimeve.

Kryetari – Për pyetjen nr. 96 duhet të organizohet seancë dëgjimore, në të cilën duhet të ftohen MTI-ja MD-ija, OEK-u OAK-u dhe AKB-ja; për pyetjen nr. 110 të kërkohej raport nga Enti i Statistikave; pyetja nr. 113 të hiqet nga veprimet e propozuara për Komisionin për Zhvillim Ekonomik; dhe pyetja nr. 120 t’i kalohet Komisionit për Buxhet, si komision i parë. Në fund kryetari tha se të gjitha veprimet duhen të përfshihen në tremujorin e parë dhe të dytë, për shkak se çështjet që mbeten në tremujorin e tretë nuk po e arrijnë efektin e duhur, për shkak se atëherë edhe po publikohet Raporti.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Miratohet Propozim-Plani i Veprimit i Kuvendit për vitin 2012 i Raportit të Progresit 2011 për Kosovën – detyrimet e Komisionit.

Më këto veprime të propozuara të njoftohet Komisioni për Integrime Evropiane.

4. Informate rreth vizitës së Komisionit në Republikën e Shqipërisë më 24 - 26 tetor 2011

Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Njësia Mbështetëse për këtë pikë të rendit të ditës e ka hartuar një informate rreth vizitës së delegacioni të Komisionit në Republikën e Shqipërisë nga data 24 - 26 tetor 2011.

Visar Ymeri – Tha se i ka disa vërejtje në lidhje me informatën, që do t'ia dërgojë me shkrim Njesisë Mbështetëse.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të informohet Kuvendi i Kosovës rreth vizitës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në Republikën e Shqipërisë, më 24 - 26 tetor 2011.

5. Të ndryshme

a) Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit për një ftesë të organizatës KFOS lidhur me organizmin e një punëtorie që do të mbahet nga data 18 - 20 nëntor në Republikën e Shqipërisë dhe i ka ftuar 5 anëtarë të Komisionit që të marrin pjesë.

b) Vizita në Autoritetin e Konkurrencës të Kosovës

Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit për vizitën në Autoritetin Konkurrencës së Kosovës më 02. 11. 2011. Theksoi se ajo agjenci ishte duke vepruar në kushte jo të mira për punë dhe për këtë do të njoftohet me anë të një letre Kryesia e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit